

# Kontributi i Rinisë dhe Diasporës në Mosrrijdhjen e Trurit

---

Raport i shkurtër



Ky raport i shkurtër është punë e grupit të të rinjve debatues që u bënë pjesë e Fushatës “Nga Fjala tek Veprimi” në kuadër të Edicionit III të Debatit Universitar, Programi Kombëtar i Debatit Rinor për Zhvillim Social dhe Ekonomik të Shqipërisë, të financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

**Autorë:**

**Sindi Caushi**

Universiteti i Tiranës

**Elisabeta Revaj**

Universiteti Ismail Qemali, Vlora

**Eranda Zorba**

Universiteti i Tiranës

**Mentoruar nga Dr. Erida Curraj, SCiDEV**

Pikëpamjet në këtë raport janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht të SCiDEV apo OSFA.

Tiranë, Qershor 2022

# ABSTRAKT

“Brain Drain”, “rrjedhja e trurit”, nënkupton emigrimin e konsiderueshëm të individëve të cilët kanë arsimim, trajnime dhe që janë profesionistë në shumë raste.

Fenomeni i “emigrimit të trurit” po merr përmasa alarmante dhe po përfshin segmentin më jetik të një shoqërie.

Qëllimi i hartimit të këtij studimi është evidentimi i problematikave me të cilat shoqërohet fenomeni i “largimit të trurit” dhe sugjerimi i zgjidhjeve praktike dhe të shpejta në zbatim për të ndihmuar në zvogëlimin e këtij fenomeni në Shqipëri si dhe joshjen e rinisë së diasporës për t’u kthyer pas.

Ky punim me fokusin në “ikjen e trurit”, rekomandon politika specifike të nevojshme për të transformuar “ikjen e trurit” në “qarkullim të trurit”, të cilat, janë grupuar në tre aksione kryesore:

- 1) tërheqja e rinisë të diasporës dhe mbajtja në vend të rinjtë Shqiptar,
- 2) përmisimi i kurrikulave në universitetet,
- 3) krijimi apo sigurimi i mirëfunksionimit të zyrës së këshillimit të karrierës nëpër universitete apo në nivel vendor.

Punimi bazohet gjerësisht në burime lokale dhe ndërkombëtare mbi këtë fenomen.

Ky punim argumenton se fenomeni i “ikjes së trurit” është një fenomen shqetësues, i cili ndikon në zhvillimin e ardhshëm të vendit.

# HYRJE

**B**rain Drain si fenomen është i përhapur dhe në shumë vende të tjera përveç Shqipërisë. Gjithashtu ky nuk është një fenomen i ri, megjithatë rritja e tij është shqetësuese. Në Shqipëri, duke krahasuar vitin 2013-2016 me 2010-2012, interesi i shtetasve shqiptarë drejt vendeve të tjera u rrit shumë.

Në Shqipëri ka një shqetësim në rritje për largimin e të rinjve nga vendi. Çdo vit, afro 10% e numrit të studentëve referuar një raporti nga INSTAT "Diaspora në Shifra, 2020" zgjedhin të studiojnë jashtë vendit. Ekspertët e shohin me shqetësim këtë fenomen, pasi kjo përbën rrjedhje të trurit dhe vendit në terma afatgjatë do t'i mungojë shtylla e shoqërisë dhe ekonomisë.

Sipas monitor.al Shqipëria, rrjedhën më të lartë të trurit në rajon, 40% e të larguarve nga 2012-2019 të arsimuar. Në anketën e vitit 2020 e profesorëve Gëdeshi dhe King, nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale me studentë, zbuloi se 79% e studentëve shqiptarë dëshirojnë të largohen nga vendi në raport me 65% në vitin 2018. Nga ana tjetër, 95% e atyre që studiojnë jashtë nuk dëshirojnë të kthehen. Sipas publikimit të INSTAT "Diaspora e Shqipërisë në Shifra" në vitin 2020, Shqipëria renditet e para edhe për numrin e studentëve që ndjekin arsimin jashtë vendit, me përkatësisht 18,181 studentë, e ndjekur nga Serbia me 15,749 studentë, pastaj Bosnja me 15,399.

Studim i Wiers-Jenssen et al. (2002) ka provuar se faktor përcaktues në kënaqësinë e studentëve është cilësia e mësimdhënies, si nga ana akademike dhe pedagogjike. Për këtë, përmbushja e dëshirave të studentëve në universitet ka rëndësi për suksesin e institucionit.

Ajo që vlerësohet e rëndësishme është frenimi i largimit të studentëve nga "pakënaqësia" kur nuk kanë mundësi zgjedhje për të studiuar apo nuk kanë ambientet, përshtatjen e duhur teknologjike, kushtet e studimit që ata aspirojnë.

Rrjedhja e trurit në Shqipëri është një problem i thellë që po e varfëron vendin nga kapitali njerëzor dhe është një pengesë e vazhdueshme për zhvillimin e vendit. Rrjedhimisht, sa më i madh numri i të larguarve nga radhët e tyre, aq më i vogël bëhet kapitali human në vend.

Për të mbajtur trurin e vendit dhe thirrur atë duhet një paketë masash që një shtet duhet të marrë në konsideratë. Ky studim ka vendosur në fokus tre masa, të cilat siç edhe do të argumentohen më poshtë janë të arritshme dhe të prekshme në kohë dhe në plan veprimi:

- a) themelimi/ përmirësimi i zyrave të këshillimit të karrierës;
- b) përmirësimi/dizenjimi i kurrikulave mësimore;
- c) politika për afrimin e diasporës në akademi dhe jo vetëm.

Në të treja pikat e punimit synohet që të shqyrtohen me detaje problematikat e ngritura, të kuptohet nga vjen problemi dhe cilat janë disa nga zgjidhjet që mund të ofrohen. Kjo është arritur nga një kërkim sistematik nëpër dokumente dhe raporte studimore të mëparshme mbi këtë temë si edhe nga intervistimi i personave përfaqësuese në institucionet që lidhen drejtëpërdrejtë me këto sugjerime.

# KURRIKULAT MËSIMORE - “JOSHJA” PËR STUDENTËT

Largimi i të rinjve, një fenomen i cili shkakton probleme komplekse shoqërore që e lënë vendin të pazhvilluar nga ana intelektuale dhe teknologjike, si dhe thellon edhe më shumë hendekun midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Për të zbutur efektin negativ të këtij fenomeni, kryesisht në vendet në zhvillim, e rëndësishme është të ndërmerren një sërë politikash që përfshijnë aspekte të rëndësishme të zhvillimit të një vendi: E para, duhet të pranojmë që emigracioni i vazhdueshëm është zakonisht simptoma, jo shkak, i një problemi themelor; E dyta, zgjerimi dhe përmirësimi i arsimit të lartë është një tjetër politikë kryesore që duhet ndërmarrë. Disa vende, si Rumania dhe Kroacia, tashmë e kanë ndjekur këtë politikë për të mbajtur më shumë studentë në vendin e tyre, të cilët aspironin për arsim me cilësi më të lartë

Fokusi i kësaj pjese është pikërisht rëndësia që ka qëndrimi i të rinjve në Shqipëri dhe kryesisht qëndrimi i studentëve duke zgjedhur Universitetet e vendit si “destinacionin e tyre”. Ajo që vlerësohet e rëndësishme është përmirësimi i pakënaqësive, kur studentët nuk kanë mundësi apo nuk kanë ambientet akademike të përshtatshme dhe me teknologjinë duhur.

Për rrjedhojë shumë universitete sot në botë kërkojnë vazhdimisht si të përmirësojnë nivelin e pritshmërisë së studentëve në institucionin e tyre.

Në sistemin e arsimit të lartë ka një shumëllojshmëri të madhe të ofertës akademike, pa kritere dhe politika strategjike planifikimi, ndërsa numri i programeve të studimit është mbi 1,300. Një vëmendje të vecantë, kurrikulave i ka kushtuar dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, e cila është ndalur në problematikat e zhvillimit të kurrikulave dhe kujdesin që duhet t'i kushtojnë. Universitetet, e pasqyruar kjo edhe në Strategjinë për arsimin 2021 – 2026. Të dukshme janë mungesa në kushtet infrastrukturore, mungesa e digjitalizimit, kurikula jo të përmirësuara, mënyra e mësimdhënies jo koherente. Kurrikulat nuk u janë përshtatur me shpejtësi ndryshimeve socio-ekonomike dhe zhvillimeve të tregut, për pasojë, ato nuk kanë qenë gjithmonë efektive. Ka pasur mungesë të një politike të zhvillimit të kurrikulave me synimin për t'i bazuar ato në kompetenca ose rezultate të të nxëniet, si dhe për t'i orientuar të rinjtë sa më mirë drejt tregut të punës.

Funksionimi i skemës nis nga rregullimi i posaçëm që realizon çdo Universitet, sepse çdo Universitet ka statutin e tij, në të cilin bëhen rregullimet e posaçme për mënyrën e organizimit dhe funksionimin e tij, por jo vetëm, në strukturën e tij ka njësi të caktuara të cilat krijohen për të vlerësuar ecurinë e kurrikulave dhe ndërmarrjen e ndryshmeve të tyre në rast nevojë. Nëse do i referohemi Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe këtu po i referohem dy krerëve, Kreut 7 "Organizmi i studimeve në institucionet e arsimit të lartë" dhe Kreu 10 "Sigurimi i cilësisë në arsim", neni 103 tregon obligimet dhe përgjegjësitë për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të cilat përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

E fillë është rasti i Statutit të Universitetit të Tiranës, i cili nga nenet 37-43 flet për krijimin dhe zgjedhjen e disa Komisioneve të posaçme në ndihmë të tij. Një prej tyre është Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës.

Për të pasur më tepër transparencë për punën e rëndësishme që zhvillon Komiteti i Përhershëm i Kurrikulës duhet të pasqyrojnë punën e tyre edhe për studentët, maturantët apo çdo person të interesuar, si një nga mënyrat për të qenë më transparente, sepse nga kërkimet e bëra në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës nuk rezulton një shfaqje e punës së Komisionit, por vetëm listimi i anëtarëve të zgjedhur. E njëjta situatë vihet re edhe në Universitetin e Sporteve .

Ndërsa Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) i ka të pasqyruara planet e veprimit të zhvilluar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) nga viti 2018 deri në vitin 2021. Puna e këtij Komisioni është e një rëndësie shumë të madhe jo vetëm për çdo universitet për ta bërë programin mësimor më të prekshëm dhe më frytdhënës, por dhe më të kërkuar nga maturantët dhe studentët.

Një strukturë brenda Universitetit që punon për përmirësimin e kurrikulave dhe cilësisë së arsimit universitar, i ndihmon studentët që të zgjedhin Universitetet vendase duke i sjellë më afër me degët dhe cilësinë që studentet e kërkojnë jashtë. Format për permisimin e kurrikulave janë disa etapshe si:

- 1) thellimi i nevojave të tregut;
- 2) takim me dhomën e tregtisë së diasporës dhe dhoma të tjera nëpër qytet (periodikisht do të ishte më mire, të bëheshin takime dëgjimore);
- 3) ti propozohet AADF me projektin READ që të shtojnë një modul për bashkëpunimin me profesorët në diasporë, me qëllimin e azhurnimit të kurrikulave;
- 4) të ndiqet nga Ministria e Arsimit vertetësia e studimit të tregut dhe nevojat e tij siç premtohet nga universitetet kur hapin një program të ri studimi.

# ZYRAT E KARRIERËS SI ZGJIDHJE PËR ZGJEDHJET

**P**ërsa i përket zyrës së këshillimit të karrierës, duke marrë shkas nga ikja e shumtë të rinjve në ditët e sotme, rëndësia e zyrës së këshillimit të karrierës për të parandaluar brain drain-in dhe joshur rininë e diasporës ka një peshë të caktuar. Zyra e këshillimit të karrierës luan një rol të rëndësishëm dhe shërben si një urë lidhëse midis tregut të punës dhe të diplomuarve. Kjo zyrë i ndihmon të rinjtë që të orientohen, informohen, të bëjnë zgjedhje për çështje të ndryshme duke përfshirë tregun e punës, programet e studimit, prirjet e tyre, krijimin e Cv dhe letrës së motivimit etj.

Zyra e këshillimit të karrierës duhet të ekzistojë që në gjimnaz për vetë faktin se në atë periudhë fillon ndarja e klasave në shkencor dhe shoqëror. Shumë student janë të paorientuar në lidhje me prirjet e tyre dhe zgjedhin të ndjekin ndarjen në bazë të mesatares ose të notes së marrë në lëndët e provimeve të lirimimit (kryesisht matematikë dhe letërsi). Kjo nuk është një zgjedhje e zgjuar për vetë faktin se marrja e notës nuk tregon shumë për prirjet personale që ka nxënësi (ka shumë nxënës që marrin nota të mira për shkak të mesatares së përgjithshme). Ndihma e ofruar nga një këshillues karriere si dhe realizimi i testeve të ndryshme psikologjike do ndihmonte ata që ti kuptonin më mirë dëshirat dhe prirjet e tyre.

Zyra e këshillimit të karrierës është e rëndësishme dhe për rininë e diasporës pasi personat e interesuar mund t'iu drejtohen kësaj zyre për të marrë një tepër informacion në lidhje me universitetet dhe për të pasur më shumë siguri dhe orientim për tregun e punës. Kjo zyrë është një formë "joshje" që mund të bëhet për rininë e diasporës pasi do i ndihmojë ata fillimisht në njohjen se çfarë ofron Shqipëria në akademi dhe në punë. Ata do të jenë të mirë informuar kur vendosin që të rrinë në Shqipëri dhe për arsytet se pse duhet që të qëndrojnë.

Zyra e këshillimit të karrierës luan një rol shumë të madh në universitete, pasi asiston studentët, nxënësit dhe personat e tjerë të interesuar.

Aktualisht edhe pse shumë universitete e kanë zyrën e këshillimit të karrierës, ajo nuk është funksionale. Universiteti i Vlorës ka Zyrën Akadematike pranë rektoratit, e cila shërben si zyrë këshillimi. Ky universitet është i ndarë në tre godina, të cilat nuk kanë zyrën e tyre të këshillimit. Në këto kushte nuk ka një qarkullim të mirë të informacionit dhe studentë hasin vështirësi.



Këtë qëndrim ka mbajtur dhe konsulentia e karrierës pranë zyrës akademike në universitetin e Vlorës, duke shprehur rëndësinë e një zyrë të tillë për punësimin e të rinjve dhe mirërritjen e diasporës. Ajo u shpreh se numri i studentëve të cilët i drejtohen kësaj zyre është shumë i vogël dhe pavarësisht organizimeve që realizon kjo zyrë me subjekte të tjerë për karrierën, nuk ka një shpërndarje të mirë të informacionit. Nga ana tjetër, shumica e studentëve nuk e kanë idenë e ekzistencës së një zyre të tillë dhe funksionit të saj.

Duke qenë se zyra e këshillit të karrierës mund të krijohet edhe me vendim senati, atëherë pse nuk realizohet diçka e tillë për të krijuar zyrë këshillimi në çdo universitet dhe fakultet (nëse këto janë të ndarë në godina)?

Nga ana tjetër Bashkia e Tiranës, e mbështetur nga projekti zviceran Risi Albania ka hapur zyrën e saj të këshillimit të karrierës. Gjithashtu, në vitin 2021 Risi Albania së bashku me Partnerët Shqiptar për Ndryshim dhe Zhvillim ndërmorën projektin për të hapur zyrën e këshillimit të karrierës në Durrës.

Thirrja e fundit e realizuar nga Risi Albania ishte ajo e datës 11 Prill 2022 për ngritjen e zyrës së këshillimit të karrierës në nivel vendor. Universitetet dhe bashkitë janë të ftuara të marrin pjesë. Në këtë projekt do të përzgjidheshin 3-4 bashki, në të cilat do të krijoheshin zyra e këshillimit. Me anë të një formulari, bashkitë do të kishin mundësi që të konkurronin. Risi Albania hap shumë shpesh thirrje të tilla prandaj është një mundësi shumë e mirë për tu shfrytëzuar.

Pjesa më e madhe e qyteteve në Shqipëri e kanë shumë të nevojshme krijimin e kësaj zyre.

Përsa iu përket sugjerimeve duhet:

- 1) të pasurohen listat e institucioneve universitare për intership-e për rininë;
- 2) të ketë takime periodike me një kalendar të percaktuar me këto subjekte, në formë workshop-i, panairësh etj;
- 3) të afrohet Dhoma e Tregtisë së Diasporës dhe të tjera që të bëjnë promovimin e kësaj zyre në subjektet e tyre;
- 4) të bëhen takime për shkëmbimin e eksperiencave më të mira, mes univesiteve që të ndërtohen këto zyra nëpër të gjithë Shqipërinë.

Per keto lloj aktivitete mund të veprojnë donatorë për të mbuluar shpenzimet si psh Risi Albania, AADF etj.

# AFRIMI I DIASPORËS NË AKADEMI DHE JO VETËM

Të dhëna të detajuara mbi emigracionin në vendet e Ballkanit Perëndimor, të analizuar nga Instituti për Studime Ekonomike Ndërkombëtare i Vjenës, tregojnë se fenomeni në Shqipëri është i përhapur tek të rinjtë dhe të arsimuarit. Ikja e trurit është veçanërisht e fortë tek të rinjtë, sidomos në grupmoshat 15-19 dhe 20-24 vjeç. Por emigrimi i forcës së aftë të punës në Shqipëri është i lartë edhe në grupmoshat 25-29 dhe 30-34 vjeç. Studimi vëren se nga një grup prej 105 mijë emigrantësh që ikën nga Shqipëria gjatë periudhës 2012-2019, kanë qenë të arsimuar 40,700 persona ose 40% e totalit të emigrantëve.

Sipas raportit të zhvilluar nga Qendra Kombëtare Burimore për të rinjtë në Shqipëri, në dhjetë vitet e fundit nga Shqipëria janë larguar 140.390 të rinj dhe të reja. Shqipëria vazhdon të ketë një numër tepër të lartë të të rinjve që largohen jashtë për një jetë më të mirë. Studime ndërkombëtare, tregojnë se ritmet e ikjes së të rinjv nga vendi ynë janë të larta, duke e detyruar Shqipërinë të shpopullohet tërësisht brenda 70 viteve të ardhshme.

Sipas këtij raporti, "Ikja e trurit të të rinjve" si ndër fenomenet më shqetësuese, pasi e rendit Shqipërinë në vendin e parë në Europë me rreth 30% të studentëve që synojnë të studiojnë jashtë vendit, ishte padiskutim një ndër gjetjet më kritike që kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga qeveria shqiptare

Ndryshimi, krahasuar me vitet 90' deri në 2000-in, është se sot kërkesën më të lartë për t'u larguar, veç studentëve, e ka edhe shtresa e mesme. Arsimimi, shëndetësia, siguria për të nesërmen, duke mos përjashtuar për asnjë moment të ardhurat nga punësimi, janë arsyt kryesore. Këto arsye i konfirmojë edhe statistikën, të cilat tregojnë se nga vendi nuk po ikin vetëm të papunët dhe të paarsimuarit. "Dekadën e fundit ikën 40% studentë, 30% me të mesme të kualifikuar. Nuk ikin në vendet fqinje por në Gjermani e vendet e Perëndimit", thotë Ilir Gëdeshi, nga Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale. Shqipëria ka numrin më të lartë të të rinjve të larguar nga vendi në krahasim me shtetet e rajonit. Janë 18 mijë studentë që kanë emigruar, 93% e të cilëve shprehin se nuk do të kthehen më në atdhe.

Sipas një Raporti të realizuar nga Qëndresa Qytetare 71% e të rinjve shqiptarë planifikojnë të emigrojnë. Arsyet kryesore janë ato ekonomike dhe punësimi, më pas renditet arsimimi dhe siguria. Gjysma e të rinjve që duan të emigrojnë (50%) preferojnë vendet e Europës Perëndimore.

55% e të rinjve mendojnë se sfidat kryesore që ka Shqipëria sot janë ekonomia, punësimi dhe arsimiti ndërsa 37% e tyre mendojnë se sfidat kryesore janë korrupsioni dhe kriminaliteti.

UNICEF dhe organizata GERMIN kanë bashuar forcat në emër të krijimit të më shumë mundësive për zhvillim profesional dhe punësim për të rinjtë e Kosovës duke shfrytëzuar potencialin e diasporës kosovare. Ky bashkëpunim ka dy synime specifike:

1. Deri në gusht të vitit 2022, 50 adoleshentë dhe të rinj (mosha 16-24 vjeç) do të kenë avancuar përgatitjen e tyre profesionale dhe ekspozimin në tregun e punës përmes mundësive të praktikave të ofruara nga diaspora.
2. Deri në fund të gushtit 2022, rrjeti i krijuar/krijuar i diasporës do të mbështesë Generation Unlimited të Kosovës, agjendën e zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Këto rezultate do të arrihen përmes takimeve avokuese me komunitetin e diasporës në Zvicër, Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

<https://germin.org/sq/germin-and-unicef-kosovo-partnering-for-the-youth-development-agenda/>

Programi i Bursave të Diasporës Greke përzgjedh 30 bursistë për të zhvilluar programe në bashkëpunim me universitetet greke. Këtë verë, tridhjetë akademikë, të lindur në Greqi dhe Qipro, nga njëzet e tetë universitete kryesore në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada, do të udhëtojnë në Greqi për të ndjekur programe me kolegët në universitetet greke në kuadër të Programit të Bursave Greke.

Programi i Bursave të Diasporës Greke (GDEP) është krijuar për të ndihmuar në adresimin e fenomenit të largimit të vazhdueshëm të shkencëtarëve nga Greqia dhe për të zhvilluar bashkëpunime afatgjata, reciprokisht të dobishme midis universiteteve greke dhe universiteteve amerikane dhe kanadeze. Programi i Bursave filloi në vitin 2016, me një donacion nga Fondacioni Stavros Niarchos (ISN). Përgjegjës për menaxhimin e programit është Instituti i Edukimit Ndërkombëtar (Institute of International Education), në bashkëpunim me Fondacionin Fulbright në Greqi.

Bashkëpunimi kërkimor midis ish-studentëve të GDFP ka rezultuar në publikimin e artikujve në revista akademike, prezantime në konferenca, seminare dhe seminare. Çështjet e ngritura mbulojnë një gamë të gjerë çështjesh, nga dizajni i operacioneve të drejtuara nga kompjuteri deri te hetimi i rrjeteve sociale midis të mbijetuarve të Holokaustit hebre. Pas përfundimit të programit të bursave, shumë bursistë vazhduan të punojnë me institucionet arsimore dhe akademikët që i "pritën" në Greqi. Pothuajse 90% e të gjithë bashkëpunëtorëve ende punojnë në projekte kërkimore me homologët e tyre në institucionet partnere.

Për të forcuar lidhjet mes institucioneve akademike greke dhe atyre ndërkombëtare, GDFP, siç është dëshmuar, ka forcuar kapacitetet kërkimore të institucioneve bashkëpunuese duke "ndërtuar" në të njëjtën kohë rrjetin profesional të bursistëve. Në dy raundet e para, GDFP mbështeti 49 bursa, duke krijuar bashkëpunime reciproke të dobishme midis akademikëve dhe universiteteve në Greqi dhe Amerikën e Veriut. Sipas hulumtimit të kryer së fundmi nga Instituti Amerikan me titull: Fenomeni i "rrjedhjes së trurit" në Greqi, në ciklin e ri, programi do të vazhdojë të punojë me institucionet arsimore në Amerikën e Veriut, por tashmë do të jetë i hapur edhe për akademikët grekë që jetojnë në Australi, Zelandën e Re dhe Afrikën e Jugut, duke zgjeruar kështu shtrirjen e tij.

Universiteti i Tiranës dhe fakultetet së bashku me departamentet përkatëse të krijojnë një mjedis të favorshëm për tërheqjen e studentëve në auditoret shqiptare, duke ripërcaktuar kuotat në mënyrë efikase dhe bazuar në kërkesën për degë specifike nga ana e të rinjve. Autoritetet shtetërore duhet të marrin masa për implementimin e politikave të punësimit të të rinjve të diasporës në vendin e tyre të origjinës.

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, në koordinim me Institutin e Arsimit Ndërkombëtar, ka krijuar Ekspertizën Kërkimore nga Programi Akademik i Diasporës (READ). Programi READ Fellowship është një projekt 7-vjeçar që lidh Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri me diasporën shkencore shqiptare dhe institucionet e tyre akademike përkatëse. Shqipëria është një nga vendet lider në botë për sa i përket migracionit ndërkombëtar, me më shumë se 1.4 milionë shqiptarë që jetojnë jashtë vendit dhe më shumë se 2500 Ph.D. mbajtësit me origjinë shqiptare. Programi READ do të japë deri në 100 grante bursash për anëtarët e diasporës akademike shqiptare dhe deri në 100 grante kërkimore për studiues rezidentë shqiptarë në katër fusha fokusi:

- a) Punime hulumtuese bashkëautore të botuara në revista të vlerësuara nga kolegët;
- b) Mbikëqyrje të përbashkëta të doktoraturës;

c) Kurrikula e re e zhvilluar dhe përditësuar;

d) Orë bashkë-mësimore.

Interesimi i lartë i akademikëve nga diaspora për të kontribuar në vendin e tyre të origjinës u vu re edhe në thirrjen e parë të Programit READ, me rreth 300 aplikime të fokusuara kryesisht në: kërkimin bashkëpunues, mbikëqyrjen e përbashkët të doktoraturës, kurrikulat, zhvillimin e kurseve, mësimdhënies, etj. AADF do të mbështesë përmes Programit READ rreth 100 akademikë nga diaspora për 7 vitet e ardhshme me një buxhet prej 2.7 milion USD.

# KONKLUZIONE DHE SUGJERIME

**A**daptimi i kurrikulave në Universitetet Shqiptare ka probleme të saj në koherencë dhe në cilësi, si e tillë, sugjerohet që të ndërmerren masa nga vetë Universitetet që t'i bëjnë funksionale strukturat që i kanë krijuar tashmë, duke krijuar plan-veprime dhe hartime të rubrikave specifike ku do konsistojë puna e tyre. Qëllim është sigurimi i cilësisë dhe ruajtja e standarteve sipas udhëzimeve të ASCAL-it. Gjithashtu duhet të krijojnë kalendar Akademik në fillim të çdo viti studimi dhe të mbajnë kontakte të rregullta me koordinatorët e fakulteteve dhe sekretarinë dhe të përfshijnë Fokus-Grupet e studentëve për të ndjekur problemet më nga afër.

Këto struktura nuk mund të punojnë të vetme për të arritur qëllimin e tyre madhor. Do të ishte e vlefshme eksperiencia e Universiteteve në shtetet e tjera, pse jo bashkëpunimi i profesorëve tanë me ata të huaj, duke marrë shkas që në qendër të strukturave për zhvillimin kurrikulave janë vetë profesorët. Për këtë arsye, sugjerohet organizimi i punëtarive (workshop), shkëmbimi i përvojave mes profesorëve, krijimi i programeve të përshtatshme për Universitetet dhe gjetja apo krijimi i mundësive për të lehtësuar adaptimin edhe nga studentët e Diasporës për të mos e patur të vështirë nëse duan të rikthehen për të vazhduar studimet universitare në Shqipëri.

Zyrat e Këshillimit të Karrierës në nivel vendor ose universitar ka shumë peshë, ajo krijon lidhjen midis të rinjve në Shqipëri dhe diasporë, këshillon për zgjedhjet në karrierë dhe punësim. Për të përmirësuar situatën, bashkitë dhe universitetet duhet që të aplikojnë në projekte të tilla si Risi Albania ose projekte të ngjashme, të lidhin partneritet me financues ose ta krijojnë vetë me vendim senati këtë zyrë duke e financuar me buxhetin e tyre.

Krahas katër fushave të fokusit që Programi READ parashikon të përfshihet dhe fusha e numrit të kuotave për aksesueshmërinë e studentëve të diasporës në këto programe që shërbejnë për të rritur kapacitetet intelektuale, akademike dhe shkencore në vend. Si model referimi shërben Greqia përmes Programit GDEP.

Duhet të merren masa për të hartuar kurrikula plotësuese për kategorinë e studentëve të kthyer. Këto kurrikula duhet të marrin parasysh gjatësinë e qëndrimit në emigracion, arsimimin, kohëzgjatjen në vendin pritës dhe aftësitë intelektuale të secilit student të kthyer.

Të vazhdohen reformat në administratën publike dhe në treguesit e qeverisjes në bashkëpunim të ngushtë me Bashkimin Europian dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë përmes LEAD ALBANIA për një periudhë më të gjatë kohore e cila mos shërbejë vetëm si shkëmbim eksperiencash por si mundësi për integrim të qëndrueshëm dhe afatgjatë të diasporës shkencore.

Vetëm transformimi i administratës publike drejt standardeve evropiane do të ishte një mënyrë efektive për të integruar shqiptarët e arsimuar jashtë në administratë. Ky pa dyshim, është një proces i ndërsjellë: përpjekjet e vazhdueshme për të përfshirë këtë grup në administratë do të ndihmojnë integrimin e vendit në BE duke përmirësuar kapacitetet shtetërore për të vënë në jetë reformat e nevojshme.

Të ripërcaktohen kuotat e diasporës në varësi të preferencave të të rinjve të diasporës , me fokusin për degë specifike, duhet të përmisohen kërkesat e aplikimit dhe detyrimeve post diplomimit të tyre si dhe këto kuota mos të jenë fiktive por pjesë e rregullores dhe Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021-2025.

# PLAN ADVOKIMI

- Takimi me personat përgjegjës për advokim janë disa por ne do të zgjedhim dy prej aktoreve të mëposhtëm: anëtar i një prej Komisioneve të kurrikulave, përfaqësues nga Bashkia Vlorë, nga organizata apo donatore si: RISI Albania, AADF dhe Germi, nga Ministria e Arsimit, përfaqësuese nga dhoma e Tregtisë së Diasporës.
- Promovimi në rrjetet sociale të këtij artikulli

READ do u prezantohen gjetjet e kerkimit si të shtojnë programin për përmisimin e kurrikulave me profesore të diasporës, administrimin e Zyrave të karrieres apo promovimin e programeve shqiptare për të afruar diasporën.

Me Dhomën e Tregtisë të Diasporës do u prezantohen gjetjet do diskutohet në lidhje me programet e investimit të rinjve në Shqipëri, për rrugët që mund të ndiqen për ti tërhequr ata, për mundësinë e bashkepunimeve ndërmjet kërkuesve dhe diasporës.

GERMIN – do të diskutohet mbi eksperiencat e/jo të mira dhe se sa e lehtë është të afrosh diasporën, njohja e projekteve të metëjshme dhe promovim të përfundimeve të këtij artikulli



# BIBLIOGRAFIA

- Ligj nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin e shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
- Gjonça et. al, "Raporti përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimitshkencor," MAS, Tiranë, 2014.
- Ejupi, Bulëza, "E ARDHMJA E EDUKIMIT DHE TEKNOLOGJITË DIGJITALE" (2021).
- European Commission/EACEA/Eurydice, The European Higher Education Area in 2018: Bologna Process Implementation Report, Luxembourg: Publications Office of the European Union., 2018.
- Anketë e vitit 2020 e profesorëve Gëdeshi dhe King, nga Qendra për StudimeEkonomike dhe Sociale me student  
<http://www.instat.gov.al/media/7848/diaspora-ne-shifra-2020.pdf>  
<https://citizens-channel.com/2020/11/05/raporti-rriten-regjistrimet-ne-deget-qe-te-cojne-jashte-vendit-59-drejtme-studimi-ne-rrezik-mbyllje/>  
<https://unitir.edu.al/9941-2/>  
<https://ust.edu.al/en/activity-events-2/>  
<https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise>
- Risi Albania, datë 11/04/2022  
<https://partnersalbania.org/News/thirrje-per-shprehje-interesi-per-ngritjen-e-zyrave-te-sherbimit-te-keshillimit-te-karrieres-ne-nivel-vendor/>
- Bashkia e Tiranës, Zyra e këshillit të karrierës  
<https://karriera.tirana.al/sherbime/>
- Strategjia e diasporës shqiptare  
<https://online.pubhtml5.com/fiit/chlo/#p=39>
- Qendra e këshillimit të karrierës në UMAD  
<https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2021/11/17/inaugurohet-qendra-e-karrieres-ne-uamd/>

